



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A. nr. 372/ 20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/20 me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “HORN & CO. KOSOVO” SHPK , të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi - ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi –ilegale dhe shërbime tjera” :AP 632-20-1610-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardia Behra me datën: 06.08.2020 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “HORN & CO. KOSOVO” SHPK me nr. të protokollit. 472/20, e datës: 11 QERSHOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rrënim - ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi –ilegale dhe shërbime tjera” :AP 632-20-1610-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës.
- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues –AK Komuna e Gjakovës, që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rrënimi -

ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi –ilegale dhe shërbime tjera” :AP 632-20-1610-5-2-1”, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

- I. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave , operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4 të Rregullorës së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.
- II. Obligohen, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Më datën: 11 QERSHOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “HORN & CO. KOSOVO” SHPK me nr. të protokolli. 472/20, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi - ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi –ilegale dhe shërbime tjera” :AP 632-20-1610-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “HORN & CO. KOSOVO” SHPK me nr. të protokolli. 472/20, të datës: 11 QERSHOR 2020, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi –ilegale dhe shërbime tjera” :AP 632-20-1610-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, dhe konstaton se ankesa duhet të hedhet si e pa lejuar nga

fakti se OE ankues nuk e ka parashtruar kërkesën në AK kundër njoftimit për dhënie të kontratës brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 108/A të LPP-së.

OSHP sqaron se me datën 28.05.2020 ora 15:26, AK e ka njoftuar OE ankues me Letrën Standarde. OE ankues me datën 05.06.2020 në ora 10:22 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së.

OSHP konstaton se në pajtim me nenin 9 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Ne rastin konkret OE ankues kundër Njoftimit të AK-së, të datës 28.05.2020 - Njoftimin për dhënie të kontratës dhe njoftimit me letër Standarde është dashtë që brenda afatit kohor prej 5 ditëve të parashtrroj kërkesë në AK.

OSHP duke pas parasysh faktin se ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së, -Njoftimit për dhënie të kontratës dhe Letrës Standarde të dt. 28.05.2020, brenda afatit ligjor prej 5 ditëve por kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në AK në ditën e 8 pas vendimit të AK-së –Njoftimit për dhënie të kontratës dhe Letrës Standarde, konstatojmë se OSHP nuk ka juridiksion që të procedoj me tuje me ankesën nr. 472/20 të dt. 11.06.2020, sepse ankuesi ka humbur afatin ligjor për ankimim në shkallen e parë në AK, pra ankuesi ka humbur afatin ligjor për shqyrtim të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të AK-së në autoritetin kontraktues sepse Njoftimi AK-së është bere me datën 28.05.2020 ndërsa OE ankues Kërkesën për Rishqyrtim të këtij vendimi –Njoftimi e ka parashtruar me datën 05.06.2020, andaj OSHP nuk vazhdon me shqyrtimin e ankesës në fjalë.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dypozitiv të këtij vendimi duke e hedhur ankesën si te pa lejuar.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së



Ardian BEHRA

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjakovës

1x1 OE "HORN & CO. KOSOVO" SHPK

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së